



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.114

3 shtator

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.513, datë 15.8.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave, për Agjencinë e Trajtimit të Kredive..	3253
Vendim i KM nr.514, datë 15.8.2007	Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.....	3264
Vendim i KM nr.517, datë 8.8.2007	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2007-2008.....	3267
Vendim i KM nr.520, datë 25.7.2007	Për shpërblimin dhe trajtimin ushqimor të punonjësve të Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, që realizuan procesin e maturës shtetërore, 2007.....	3275
Vendim i ERE nr.50, datë 24.8.2007	Për fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për lehtësimin e hyrjes në rrjet të centraleve elektrike, me kapacitet të përgjithshëm, jo më të madh se 5 MW.....	3275
Vendim i ERE nr.51, datë 24.8.2007	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit për licencimin e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre	3276
Kërkesë e MPPTT nr.5417, datë 24.8.2007	Për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të pronarit z.Hysni Abdyl Qefalia, që preket nga zgjerimi i varrezave të Tufinës, Bashkia Tiranë.....	3276

VENDIM
Nr.513, datë 15.8.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË FINANCAVE, PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave, për Agjencinë e Trajtimit të Kredive, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista përbëhet nga 10 (dhjetë) fletë.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe Kryeregjistruesi i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Agjencia e Trajtimet te Kredive				Identifikoi:				Elsa Bare Pergjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)				E. Bare			
Bashkia TIRANE				Supervizori:				Pranvera Shehi. Ing. Vleresimi ne S/Administrimit te Objekteve te Sekuestruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)				Pranvera Shehi			
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimet te Kredive				Aprovoi:				Dilaver Stafa. Drejtor i Pergjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)				Dilaver Stafa			

A				B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8220	3/89+1-10	Truall ndertese	Zyra Rajonale e A.T.K Tirane Rr.Frosina Plaku, Pallati 38/1 sh.1.k1.Ap10 Tirane	213	98	Zyra per ATK	Ministria e Financave D.P.e ATK-se	D.P. e ATK-se	Apartament 3+1 ne rreze pallat bani mi 5 katesh .Ish zyrtar e BTA-se Me certificate pronesia per ATK

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Agjencia e Trajimit te Kredive Bashkia PUKE Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per ATK-ne				Identifikoi: Elsa Bare, Pergjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Pranvera Shehi, Ing. Vleresimi ne S/Administrimit te Objekteve te Sekuestruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Dilaver Stafa, Drejtor i Pergjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)				Te dhenat e tjera (Shenime te vecanta)			
A				B				C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti per dorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhenat e tjera (Shenime te vecanta)	
1	3069	1	Truall Ndertese	Zyrat Rajonale te ATK Puke	156.6	156.6	Zyra per ATK-ne Puke	Ministria e Financave ATK	DP e ATK	Ambjent 3+1 ne katin perdhete rreze godine 3 kateshe. Ne katin e dyte dhe te 3 ndodhen nenprefektura	
										Me certifikate pronesia ne emer te ATK	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per inventarizimin e pronave te veçanta)


Agjencia e Trajtimin te Kredive Bashkia BERAT				Identifikoi: Elsa Bare, Përgjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)				Supervizoi: Pranvera Shehi, Ing. Vleresimi ne S. Administrimi i Objekteve te Sekuestruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)				Aprovoi: Djalaver Stafa, Drejtor i Përgjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vete)			
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimin te Kredive															
A				B				C							
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me perjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)					
1		3	4	5	6	7	8	9	10	11					
1			Ndertese Truall	Zyrat e Agjencise se Trajtimin te Kredive L. "Jani Vreto" Rr nacionale Berat-Skrapar	459	459	Zyra rajonale Berat	Ministria e Financave ATK	ATK	Kati i pare dhe gjysma e katit te dyte te nje godine 4 kateshe. Pjesa tj e godines eshte Shendet publik, dhe zyra te tjera.					

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Agjencia e Trajtimet te Kredive Bashkia KORCE				Identifikoi: Elsa Bare Pergjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Supervizoi: Pranvera Shehi Ing. Vleresimi ne S. Administrimit te Objekteve te Sekuestnuara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Aprovoi: Dilaver Stafa Drejtor i Pergjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)						
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimet te Kredive				C						
A			B		C					
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasunise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdooret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Truall Ndertese	Zyrat e ATK-se Korce Bulevardi Gjergj Kastrioti Korce Godine dy kateshe	140	140	Zyra ATK	Ministria e Financave	DP e ATK	Godina eshte 2 kateshe + papafin valem kati i pare eshte i perfundua kated e tj. Jane pa mbanuar punime

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Agjencia e Trajimit te Kredive Bashkia GJIROKASTER				Identifikoi: Elsa Bare, Përgjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Pranvera Shehi, Ing. Vleresimi ne S.A.O.P (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Djalaver Stafa, Drejtor i Përgjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)				  			
A				B		C					
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdonues Statusi juridik i perdonimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)	
1		3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1			Truall Ndertese	Zyra Rajonale e ATK-se L. "Varosh" Rruga e Pazarit Gjrokaster	60.7	60.7	Zyra per ATK	Ministria e Financave ATK	DP e ATK	Apartament 1+1 ne katin e dyte te nje pallati banimi 4 katesh	


1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Agjencia e Trajtimet te Kredive Bashkia SHKODER				Identifikoi: Supervizori:				Elisa Bare Pergjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Pranvera Shehi. Ing. Vleresimi ne S.Administrimit te Objekteve te Sekuestruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)					
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimet te Kredive				Aprovoi:				Dilaver Stafa. Drejtor i Pergjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)					
A				B				C					
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11			
1			Truall Ndertese	Garazh makine	19	19	Garazh	Ministria e Financave	DP.e ATK	Pjese e nje ndertese nje kateshe me 5 garazhe			

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Agjencia e Trajtimt te Kredive		Identifikoi:		Elsa Bare, Përgjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		 	
Bashkia		Supervizoi:		Pranvera Shehi, Ing. Vleresimi ne S. Administrimit te Objekteve te Sekuestruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimt te Kredive		Aprovoi:		Dilaver Stafa, Drejtor i Pergjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)			

A			B			C				
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Truall Ndertese	Zyre e ATK-se Lagja nr. 1 Pallati ku ndodhet Raiffeizen Bank	18	18	Zyre per ATK	Ministria e Financave	DP e ATK	Nje zyr e vendosur ne katin e pare te nje godine 5 kateshe Tek Raiffeizen Bank

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Agjencia e Trajtimin te Kredive Bashkia KAVAJE				Identifikoi: Elsa Bare, Pergjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)				Supervizoi: Pranvera Shehi, Ing. Vleresimi ne S. Administrimit te Objekteve te Sekuestruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)				Aprovoi: Dilaver Stafa, Drejtor i Pergjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)			
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimin te Kredive															
A				B				C							
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti per dorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)					
1		3	4	5	6	7	8	9	10	11					
1			Truall Ndertese	Zyrat e ATK-se L.nr.5 Bulevardi kryesor Kavaje	1009	655	Zyra per ATK	Ministria e Financave	DP. ATK	Godine nje kateshe me oborr me murr rethues jane vendosur zyrtat dhe nje magazine e ATK-se					

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Agjencia e Trajtimt te Kredive Bashkia Lushnje				Identifikoi: Elsa Bare: Përgjegjse Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Pranvera Shehi. Ing. Vleresimi ne S.Administrimit te Objekteve te Sekuestruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Djalaver Stafa. Drejtor i Përgjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)				Supervizoi: Aprovoi:			
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimt te Kredive											
A				B		C					
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1			Truall Ndertese	Zyra per ATK L."Skender Libohova"Perball Bashkise Lushnje	48	48	Zyra per ATK	Ministria e Financave	DP. E ATK	Nje zyre ne katin e pare te nje godine 2 kateshe,perball Bashkise Lushnje.	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Agjencia e Trajtimin te Kredive		Identifikoi:		Elsa Bare, Pergjegjese Sektorit te Administrimit te Brendshem (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Pranvera Shehi, Ing. Vleresimi ne S. Administrimit te Objekteve te Sekuesteruara (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Dilaver Stafa, Drejtor i Pergjithshem i A.T.K-se (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)		
Bashkia SARANDE		Supervizori:								
Fusha e perdorimit te Prones: Zyra per Agjencine e Trajtimin te Kredive		Aprovoi:								
A		B		C						
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdonues Statusi juridik i perdonimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Truall Ndertese	Zyra e ATK-se L. nr. 1 Rr. Mustafa Matohiti Sarande	25	25	Zyre per ATK	Ministria e Financave	DP e ATK	Nje zyre e ndodhur ne katin e pare te nje godine 4 kateshe. Ish Banka e Kursimevee cila eshte ndare ne Zyra e Pensioneve+ Zyra e ATK

VENDIM
Nr.514, datë 15.8.2007

**PËR INFORMATIZIMIN E LLOGARITJES SË KOSTOS DHE HARTIMIN E MANUALEVE
TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të neneve 10 e 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave e të analizës së kostos për punimet e ndërtimit, sipas programeve kompjuterike të miratuara për lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në këtë fushë, lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar të punimeve të ndërtimit dhe shmangien e informalitetit në veprimtarinë prodhuese, në tregun e ndërtimeve në Shqipëri.

2. Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet në përputhje me këtë vendim.

3. Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit të çdo prokurimi, me fonde publike, në fushën e projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe e kontabilitetit teknik për çdo punim ndërtimi.

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e përdorura në këtë vendim kanë kuptimin, si më poshtë vijon:

a) punime ndërtimi, quhen të gjitha punimet e ndërtimit, sipas përkufizimit të bërë në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave;

b) subjekt licencues, është organizmi shtetëror, që pajis me licencë, teknike ose tatimore, subjektet private apo publike, që veprojnë në fushën e tregtimit të materialeve të ndërtimit dhe/ose të ndërtimit;

c) subjekt ndërtues, është subjekti i licencuar, që realizon një ose më shumë zëra pune, në zbatimin e punimeve të ndërtimit;

ç) subjekte deklaruese, janë të gjitha subjektet, private dhe/ose publike, që kryejnë veprimtari në fushën e prodhimit të materialeve të ndërtimit, të tregtimit të tyre ose në fushën e ndërtimit, sipas përkufizimit të bërë në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe që, në bazë të këtij vendimi, detyrohen të paraqesin formularët e deklarimit të çmimit të materialeve të ndërtimit, që tregtojnë dhe/ose të zërave të punimeve të ndërtimit, që kryejnë;

d) program i miratuar për analizën e kostos, është çdo program kompjuterik, i certifikuar nga këshilli teknik i Institutit të Ndërtimit (IN), i miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, i cili është i regjistruar në Drejtorinë e Patentave dhe të Markave;

dh) manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit ose thjesht manuali i çmimeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe i analizave teknike të çmimeve, i detyrueshëm për zbatim, sipas pikës 2 të këtij vendimi;

e) buletini i çmimeve të materialeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe i produkteve për ndërtim, të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit;

ë) formularë deklarimi, janë formularët, që plotësohen dhe dorëzohen çdo tre (3) muaj, nga subjektet deklaruese, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e ndërtimit e që mundësojnë administrimin e të dhënave, për llogaritjen e kostos së punimeve të ndërtimit. Formularët e deklarimit duhet të përmbajnë:

i) Për prodhuesit e materialeve të ndërtimit, në përputhje me licencën, që zotërojnë:

- analizën tekniko-financiare të prodhimit;
- skedën teknike të çdo materiali (analizat laboratorike);
- emrin dhe kodin e saktë të çdo materiali, sipas standardit të referimit;

- çmimin përkatës të çdo materiali.

ii) Për importuesit e materialeve të ndërtimit:

- skedën e teknike të çdo materiali, të importuar, sipas standardit të vendit të origjinës;

- emrin dhe kodin e saktë të çdo materiali, sipas standardit të referimit;

- çmimin përkatës të çdo materiali.

iii) Për ndërtuesit, që përdorin materialet e ndërtimit, sipas përdorimeve përkatëse:

- analizën tekniko-financiare të zërit të punës;

- specifikimet teknike të materialeve dhe të teknologjisë së përdorur.

f) materiale ndërtimi janë të gjitha materialet, që përdoren në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përfshirë lëndën e parë dhe materialet ndihmëse, në përputhje me standardet e miratuara dhe/ose në përputhje me direktivën europiane për produktet e ndërtimit.

5. Për përditësimin e analizave teknike të çmimeve dhe të manualeve të çmimeve për punimet e ndërtimit, në përputhje me metodologjinë dhe formatin e miratuar e të informatizuar, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit krijohet Sektori i Standardizimit të Kostos (SSK). Ky sektor përbëhet nga 4 veta, nga të cilët, njëri me profesion “inxhinier ndërtimi”, caktohet përgjegjës dhe 3 specialistë, nga të cilët 1 ekonomist, 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier mekanik.

6. Misioni dhe detyrat e SSK-së përcaktohen në rregulloren e brendshme të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ku, përveç të tjerave, ky sektor kryen edhe detyrat, sa më poshtë vijon:

- administron programin e miratuar, duke respektuar të drejtën e autorit;

- administron formularët e vetëdeklarimeve dhe pasuron bazën e të dhënave të manualit;

- përditëson dhe pasuron manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, përfshirë analizat teknike të tyre, si dhe buletinin e çmimeve të materialeve të ndërtimit, me të dhënat e përftuara nga administrimi i vetëdeklarimeve;

- informatizon të dhënat e përftuara nga formularët e vetëdeklarimeve, për krijimin në manual të kodit përkatës, për çdo material ndërtimi dhe për çdo proces pune ndërtimi, si dhe për përfshirjen e zërave të rinj të punimeve, jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së tyre;

- boton buletinin e çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe manualin teknik të çmimeve të ndërtimit dy herë në vit respektivisht, jo më vonë se data 30 prill dhe 31 tetor, të çdo viti;

- ndërton dhe administron sistemin “on-line” të buletinit të çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe të manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, duke e pasuruar atë në mënyrë të vazhdueshme me materialet dhe produktet e reja të ndërtimit, si dhe me zërat e rinj të ndërtimit, që vetëdeklarohen nga subjektet deklaruese;

- informon të gjitha subjektet licencuese, edhe pa kërkesën e tyre, për respektimin e detyrimeve;

- bashkëpunon me organet tatimore përkatëse për sanksionet e vendosura ndaj subjekteve, që nuk kanë përmbushur detyrimet, sipas këtij vendimi;

- përfshin në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit dhe/ose në buletinin e çmimeve të materialeve dhe produkteve për ndërtim të gjitha deklaratimet e subjekteve, jo më vonë se 10 ditë nga data e deklarimit të tyre pranë SSK-së;

- njofton me shkrim, subjektin deklarues brenda 10 ditësh, nga data e vetëdeklarimit, për kodin përkatës në buletinin e materialeve të ndërtimit ose për refuzimin e tij, në rast mospërputhshmërie me standardet në fuqi.

7. Të gjitha subjektet e licencuara private, që kryejnë veprimtari në tregtimin e materialeve të ndërtimit apo të produkteve për ndërtimin detyrohen të paraqesin çdo tre muaj, respektivisht, në fund të çdo tremujori, pranë degës së tatimeve, ku ata janë të regjistruar, listën e çmimeve të materialeve apo produkteve, që tregtojnë. Lista e çmimeve dorëzohet në afatet e caktuara për dorëzimin e deklarimit të TVSH-së. Mosdorëzimi i listës së çmimeve dhe shitja e materialit në treg me çmim më të lartë se ai i deklaruar në listën e çmimeve dënohen, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.9, datë 25.6.2007 të Ministrit të Financave.

8. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit detyrohen të paraqesin pranë SSK-së analizat teknike dhe çmimet për çdo zë pune në ndërtim, për materialet e reja dhe/ose për teknologjitë e reja, të përdorura prej tyre, për të cilat nuk ekziston një analizë teknike e çmimit.

Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, duke përdorur programin e miratuar.

9. Preventivat, pa përjashtim, për objektet e reja, me financimin, publik ose privat, të projektuara nga subjekte, shtetërore apo private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, bazuar në analizat teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit, të përfshira në manual.

10. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tendera publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.

11. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve.

12. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve, të llogaritura, me programin e miratuar.

13. Për të shmangur informalitetin dhe për të vënë në barazi ligjore të gjithë tatimpaguesit, të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit dhe detyrimet e tjera, të lidhura me veprimtarinë ndërtuese, në fushën e ndërtimit, përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, të llogariten sipas vlerave faktike të punimeve, të zbërthyera sipas strukturës së kostos, në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, bazuar në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin e çmimeve të ndërtimit.

14. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ka detyrimin të botojë manualin e çmimeve të ndërtimeve dhe të analizave teknike të çmimeve çdo gjashtë muaj. Manualin e çmimeve dhe analizat teknike të tyre do të jenë të ndara sipas tri rajoneve kryesore të vendit, përkatësisht veri, qendër dhe jug.

15. Të gjitha subjektet deklaruese janë të detyruara të depozitojnë pranë SSK-së formularët e parë të deklarimit dhe një kopje elektronike të tyre, jo më vonë se 2 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Formularët e deklarimit, në formatin standard, sipas udhëzimit përkatës, që do të nxjerrë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dorëzohen pranë degëve të tatimeve, ku subjektet deklaruese janë të regjistruara, në të njëjtën datë me dorëzimin e formularëve të deklarimit të TVSH-së. Formularët e deklarimit, në format të shtypur, duhet të jenë të nënshkruar dhe të vulosur nga subjektet deklaruese.

16. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të përcaktojë, me përzgjedhje, brenda muajit gusht 2007, programin e miratuar, që do të adoptohet për t'u përdorur nga institucionet shtetërore, për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve të çmimeve. Kriteret e përzgjedhjes do të miratohen nga Task-Forca, e ngritur me urdhrin nr.110, datë 12.7.2007 të Kryeministrit.

17. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore të planifikojnë investimet për vitin 2008, në bazë të çmimeve, të përcaktuara në manualin teknik të çmimeve dhe të analizave teknike të tyre. Për këtë qëllim buletini i parë me çmimet e materialeve të ndërtimit dhe manuali i parë teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit, përfshirë analizat teknike të tyre, të përgatiten dhe të dalin në qarkullim, jo më vonë se data 30 gusht 2007.

18. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

19. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.517, datë 8.8.2007

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË
PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2007-2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 pika 3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2007-2008, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, të jetë:

- | | |
|---|---------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me numër të mbyllur | 15 050; |
| b) Kuota për program të dytë studimi | 400; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 400; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj | 50. |

2. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë me numër të mbyllur, përbëhet nga:

- | | |
|---|---------|
| a) Kuota për kandidatët brenda territorit të vendit | 14 608; |
| b) Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 442. |

3. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet institucioneve publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit, janë pasqyruar në tabelën nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, ndërsa kuotat për programet e studimit, ku pranimi është i lirë, janë pasqyruar në shkronjën “H”, në tabelën nr.1.

4. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave bëhet nga ministritë respektive të arsimit, të cilat sjellin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat e kandidatëve fitues. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i përcjell këto lista në institucione publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit, janë pasqyruar në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimeve për shtetas të huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bazë të marrëveshjeve dy e shumëpalëshe.

6. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë në vitin akademik 2007-2008, të jenë:

- | | |
|---|--------------|
| a) Në Universitetin e Tiranës: | |
| 1. Për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës | 15 000 lekë; |
| 2. Për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, | 15 000 lekë; |
| 3. Për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale | 30 000 lekë; |
| 4. Për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Drejtësisë | 30 000 lekë; |
| 5. Në programin e studimit të mjekësisë dhe për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Infermierisë | 25 000 lekë; |
| 6. Në programet e studimit të stomatologjisë, të shëndetit publik dhe të farmacisë, në Fakultetin e Mjekësisë | 30 000 lekë; |
| 7. Për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Histori-Filologjisë | 20 000 lekë; |
| 8. Për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Ekonomisë | 25 000 lekë. |
| b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës: | |
| 1. Në programin e studimit arkitekturë | 30 000 lekë; |

2. Në programin e studimit inxhinieri ndërtimi	25 000 lekë;
3. Në programet e studimit inxhinieri elektrike dhe inxhinieri elektronike	20 000 lekë;
4. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 00 lekë.
c) Në Akademinë e Arteve:	
1. Në programin e studimit regji filmi	80 000 lekë;
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	30 000 lekë.
ç) Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, për të gjitha programet e studimit	20 000 lekë.
d) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:	
1. Në programet e studimit drejtim fermash dhe agrobiznes, ekonomi dhe politikë agrare, inxhinieri pyjesh, inxhinieri e përpunimit të drurit, si dhe veterinari	20 000 lekë;
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
e) Në Universitetin e Elbasanit:	
1. Në programet e studimit gjuhë-letërsi, gazetari, punë sociale, si dhe psikologji	15 000 lekë;
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
ë) Në Universitetin e Gjirokastrës dhe në Universitetin e Korçës: Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.
f) Në Universitetin e Shkodrës:	
1. Në programet e studimit gjuhë-letërsi, punë sociale, psikologji	15 000 lekë;
2. Në programin e studimit të drejtësisë	16 000 lekë;
3. Për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
g) Në Universitetin e Vlorës:	
1. Në programin e studimit të drejtësisë	20 000 lekë;
2. Në programet e studimit gjuhë-letërsi dhe pedagogji e specializuar	15 000 lekë;
3. Për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
gj) Në Universitetin e Durrësit: Për të gjitha programet e studimit	15 000 lekë.

6.1 Kandidatët që do të fitojnë të drejtën, për të ndjekur një program studimi, të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin e ri akademik 2007-2008, studentët e viteve më të larta, të cilët vijnë nga shtresat sociale, si të verbër/shurdhër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës apo, që vijnë nga shtresa e të përndjekurve politikë, përjashtohen nga tarifa e shkollimit.

7. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët e viteve të dyta janë sipas pikës 6 të këtij vendimi, ndërsa për vitet e tjera më të larta të jetë 12 000 lekë.

8. Në çdo program studimi, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit 5 (pesë) studentët me rezultatet më të larta nga nota mesatare e shkollës së mesme dhe e provimeve të maturës shtetërore, po në asnjë rast, këtë përjashtim nuk e përfitojnë studentët me notën mesatare më të ulët se 8 (tetë).

9. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

10. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi dhe kuotat e transferimeve shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë, në bazë të kërkesave të paraqitura prej tyre.

11. Transferimet në vite të ndryshme të studimeve bëhen në përputhje me kuotat e përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi. Këto transferime, në numrin përkatës të kuotës që shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në kërkesat e institucioneve të ndryshme publike të arsimit të lartë, bëhen nga vetë këto institucione, sipas statutit dhe rregullores së studimeve.

12. Kandidatët, që do të vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi, sipas pikës 10 dhe studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet, sipas pikës 11 të këtij vendimi, u nënshtrohen tarifave të shkollimit, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët, me nr.13, datë 28.5.2007 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Financave.

13. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur në marrëveshjet zyrtare shtetërore janë përcaktuar mënyra të tjera për caktimin e tarifave.

14. Mënyra e plotësimit të kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KUOTAT KRYESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2007-2008

Tabela Nr. 1

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AETS	UD	Σ
1	Histori	100						90					190
2	Gjeografi	100						90					190
3	Histori-Gjeografi				80	70			80				220
4	Gjuhë Letërsi	100			100	60	100	120	160				640
5	Edukim Qytetar				100								100
6	Anglisht	200			150	100	120	200	H			150	920
7	Frëngjisht	100			H			50					150
8	Italisht	110			50	H		65	H				225
9	Gjuhë Ruse	30											30
10	Gjermanisht	110			H			50					160
11	Gjuhë Letërsi Greke	50				H							50
12	Gjuhë Turke	30											30
13	Cikli i Ulet				200	H	100	H	150			200	650
14	Cikli i Ulet Parashkollor				100	H	100	H	H				200
15	Ekspert ne Proceset e Formimit											50	50
16	Fizikulturë							60			120		180
17	Matematikë	120					100	H					220
18	Fizikë	120						H					120
19	Inxh. Matematike dhe Informatike	80							H				80
20	Matematikë-Fizikë												H
21	Biologji (Kimi)	80			80	60		H					220
22	Kimi	60											60
23	Biologji Mjedisore	40							80				120
24	Kimi Teknologjike dhe ushqimore	60											60
25	Kimi Industriale	60											60
26	Matematikë-Informatikë					H							H
27	Informatikë	70						60					130
28	Teknologji Informatiomi								H				H
29	Gazetari	50			80			60					190
30	Punë Sociale	100			100			60					260
31	Filozofi-Sociologji	100			70		80						250
32	Pedagogji e Specializuar								30				30
33	Psikologji	100			80			60					240
34	Shkenca Politike	100											100
35	Drejtesi	600						100	100				800
36	Regji Filmi dhe TV									10			10
37	Aktivim									14			14
38	Regji									8			8
39	Skenografi-Kostumografi									8			8
40	Koreografi									12			12
41	Pikturë									50			50

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	Σ
42	Skulpture									12			12
43	Muzikologji									8			8
44	Kompozim									6			6
45	Dirigjim									6			6
46	Piano									8			8
47	Violine									8			8
48	Violoncel									3			3
49	Viole									6			6
50	Kitare									6			6
51	Kontrabas									3			3
52	Flaut									5			5
53	Oboe									3			3
54	Klarinete									5			5
55	Fagot									3			3
56	Komo									2			2
57	Trombe									2			2
58	Trombone									2			2
59	Basub									1			1
60	Kengejare									12			12
61	Shendet Publi	80											80
62	Mjekesi	250											250
63	Stomatologji	100											100
64	Farmac	80											80
65	Infemieri	250			150	100	120	120	150				890
66	Mani	50			40		40	90					220
67	Laborator	35											35
68	Fizioterapi	30						30					60
69	Logopedi	15											15
70	Imazheri	30											30
71	Administrim Publik					60							60
72	Administrim-Biznes	460			100		60	80	240			180	1120
73	Ekonomiks	70			100								170
74	Finance	460			100	70	60	H					690
75	Info.Ekonomike	60											60
76	Admin.Biznes(Surande)	200											200
77	Turizem					50	80	H	H			180	310
78	Marketing						80						80
79	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	
80	Inxh. Detare								H				H
81	Navigation								H				H
82	Mekanikë		150										150

KUOTAT KRYESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2007-2008

Tabela Nr. 1

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	Σ
83	Insh. Materiale		H										H
84	Tekstil dhe Mode		60										60
85	Elektrik		70										70
86	Elektronik		50										50
87	Insh. Informatike		100										100
88	Insh. Telekomunikacioni		100										100
89	Insh. Mekatronike		60										60
90	Ndërtim		150										150
91	Hidroteknike		100										100
92	Arkitekturë		100										100
93	Insh. Matematike		60										60
94	Insh. Fizike		60										60
95	Insh. Gjeodet		60										60
96	Insh. Ambienti		50										50
97	Insh. Ne shkencat e tokës		70										70
98	Gjeoinformatike		80										80
99	Insh. i Gjeobuzimeve		150										150
100	Drejtim Fëmash dhe AGB			250			H						250
101	Ekonomi dhe P. Agrarë			250									250
102	Financë-Kontabilitet			200									200
103	Insh. Agrarë ne Hortikulture			100			H						100
104	Insh. Agrarë ne MB			50									50
105	Insh. Agr. në P. Bimor			H			H						H
106	Insh. Agrar ne Zootek. dhe B.Blek			H									H
107	Atuakulturë dhe M. Peshkimi			100									100
108	Agronjedia dhe Ekologji			100									100
109	Tek. Agroushqimore			100									100
110	Asistent Ligjor											40	40
111	Asistent Administrativ											20	20
112	Ndihmes Infermier											60	60
113	Ndihmes dentist											20	20
114	Spec. Rrjetesh Kopjuterike											40	40
115	Menaxhim Ndërrimi											H	H
116	Menaxhim Transporti											H	H
117	Teknologji Automobilitesh											H	H
118	Vrështari dhe Enologji			50									50
119	Insh. Pyjesh			50									50
120	Insh. P. Druvi			50									50
121	Veterinari			70									70
	GJITHSEJ	4840	1470	1370	1680	570	1040	1385	990	203	120	940	14608

KUOTAT PER KANDIDATET NGA TROJET PER VITIN AKADEMIK 2007-2008

Tabela Nr.2

		KOSOVA					MACEDONI					MALIZI					PRESHEVA												
Nr.	DEGA	UT	AA	UBT	USH	AS	UE	UPT	UT	UPT	UBT	UE	ASP	AA	UK	UT	UPT	UBT	USH	AS	AA	UT	UPT	UBT	AA	USH	UE	AS	Σ
1	Histori	2						1								1						1						5	
2	Gjeografi	2						1								1						1						5	
3	Histori-Gjeografi						2						1						2							1		8	
4	Gjuhe Letersi	1			2		2	1					2			1			2			2			1			12	
5	Edukim Qytetar						2						1									1				1		4	
6	Anglisht	2			2		1	1					1			1			1			1			2			12	
7	Italisht				2		1						1						1						1			6	
8	Gjermanisht				2											1			1						1			5	
9	Turqisht	2						1																				3	
10	Cikhi i Ulet				2		3						2		1										1			9	
11	CU Parashk.				2		3								1				2						1			11	
12	Fizikulturë					2							1							1								5	
13	Matematikë	2			2			1							1	1			1			1			1			10	
14	Fizikë	1			2			1								1						1			1			6	
	Biologji																											1	
15	Biologji-Kimi				1		2						1						1						1			6	
16	Kimi	2																										2	
17	Kimi Ushqimore	1																										1	
18	Kimi Industriale							1																				1	
19	Informatikë				1			1											1			4			3			10	
20	Gazetari	2					1	1					1			1			2			1						9	
21	Punë Sociale	1					2	1					1			1						1						7	
22	Filozofi-Soc.	1						1							1	1					1							5	
23	Psikologji	1			1			1							1				2			3			1			10	
24	Shkencat Pol.	2						1							1						2							6	
25	Drejtesia	3			1			3							2				3			2						14	
26	Art Skenik		5										2								1				1			9	
27	Arte Figurative		2											1							1				1			5	
28	Muzikë		5										3								2							10	
29	Mjekësi	1						3								1					5							10	
30	Stomatologji	1						1							1						5							8	
31	Farmacit	1						2							1						5							9	
32	Infermeri	5			2		4	5				2			2	2			6			5			1			34	
33	Ekonomiks	2						2								2						1						7	

Vendet e infermierise jane per infermieri te pergjithshme por nga universitetet ka vende per dege te vecanta te infermierise si Mami dhe Fizioterapi

VENDIM
Nr.520, datë 25.7.2007

PËR SHPËRBLIMIN DHE TRAJTIMIN USHQIMOR TË PUNONJËSVE TË AGJENCISË QENDRORE TË VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE, QË REALIZUAN PROCESIN E MATURËS SHTETËRORE, 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, deri në 2 (dy) paga mujore, të 13 (trembëdhjetë) punonjësve, të angazhuar për realizimin e maturës shtetërore, 2007, në periudhat e KOEPS-eve (Koha e ekspozimit potencial të sekretit), në varësi të kontributit të secilit punonjës në këtë proces.

2. Trajtimin me kuotë ushqimore, në shumën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë, për të gjithë punonjësit e angazhuar në realizimin e maturës shtetërore, 2007, përfshirë dhe përzgjedhësit e testeve përfundimtare, në të gjithë periudhën e KOEPS-eve.

3. Periudhat e KOEPS-eve për realizimin e maturës shtetërore, 2007, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, miratuar për vitin 2007.

5. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.50, datë 24.8.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR LEHTËSIMIN E HYRJES NË RRJET TË CENTRALEVE ELEKTRIKE, ME KAPACITET TË PËRGJITHSHËM, JO MË TË MADH SE 5 MW

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 dhe 42 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike ERE, në mbledhjen e tij të datës 24.8.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për lehtësimin e hyrjes në rrjet të centraleve elektrike, me kapacitet të përgjithshëm, jo më të madh se 5 MW.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.51, datë 24.8.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALB WIND ENERGY” SHPK PËR AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE
SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA ANA E TYRE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr.44, datë 24.7.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18 pika 1 germa “a” dhe neni 19, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 24.8.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Alb Wind Energy” sh.p.k. për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me ERE (Park Eolik VISU dhe TERPAN), si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-S
Bujar Nepravishta

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të pronarit z.Hysni Abdyl Qefalia, që preket nga zgjerimi i varrezave të Tufinës, Bashkia Tiranë.

Subjekti kërkues është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personin që preket nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet prej 4563 m². Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personi që ka emrin, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

Fatura, sipas formatit të mësipërm, t’i dërgohet për likuidim Bashkisë Tiranë.

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONIT DHE PRONËN QË DO TË
SHPRONËSOHET PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË TUFINËS, NË BASHKINË TIRANË**

Nr.	Pronari që do të shpronësohet	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në lekë	Emri i pronarit
1.	Truall	m ²	4563	4000	18252000	Hysni Abdyl Qefalia
	Shuma				18252000	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 31.8.2007
Doli nga shtypi më 3.9.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 28 lekë